



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET



PLAN PUNE

2021

Objektivat kryesore dhe pritshmëritë; drejtimet dhe mënyrat
e realizimit.

PËRMBAJTJA

1) HYRJE.

2) OBJEKTIVAT PËR VITIN 2021.

3) DREJTIMET KRYESORE DHE MËNYRAT E REALIZIMIT.

4) PROJEKTET E KSHK –SË.

5) PARASHIKIMI BUXHETOR ME ZËRAT PËRKATËS.

1) HYRJE

Bazuar në detyrat institucionale të parashikuara në VKM nr. 459, datë 23.09.1999, në përvojën shumëvjeçare të tij, në Planin Buxhetor Afatmesëm 2021-2023, në strukturën organizative dhe burimet financiare të Komitetit Shtetëror për Kultet, në Raportin Vjetor të 2020, në strategjitë ndërsektoriale, në pritshmëritë që qeveria dhe situata kombëtare dhe ndërkombëtare parashitrojnë lidhur me çështjet fetare, hartohet Plani Vjetor i Punës për vitin 2021.

Dinamikat, brenda dhe jashtë Komitetit shtetëror për Kultet, faktorët e ndryshëm që ndikojnë në trajtimin e çështjeve me ndjeshmëri dhe pjekuri, rezultatet e arritura gjatë vitit të kaluar dhe rekomandimet e evidencuara nga analiza vjetore e aktivitetit institucional për 2021, diktojnë përpilimin e planit të mëposhtëm.

2) OBJEKTIVAT PËR VITIN 2021

Komiteti Shtetëror për Kultet zbaton politikën shtetërore në fushën e marrëdhënieve ndërmjet Shtetit dhe bashkësive fetare në Republikën e Shqipërisë, përfshirë edhe shoqatat/organizatat/fondacionet me karakter humanitaro – fetar, duke krijuar kushtet ligjore e financiare për të përmirësuar cilësisht këto marrëdhënie. Ky institucion, duke iu përmbajtur legjislacionit në fuqi, mbështet financiarisht bashkësitë fetare të cilat kanë nënshkruar marrëveshje me shtetin për përmirësimin e infrastrukturës së tyre administrative, arsimore, shpirtërore e kulturore, si faktorë bazë të cilët ndihmojnë rritjen e pavarësisë e tyre ekonomike, ruajtjen e traditës, harmonisë dhe tolerancës fetare në vend.

Nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet shtetërore, bazuar në aktet ligjore dhe nën-ligjore në fuqi për fenë, mbështet direkt bashkësitë fetare në veprimtari të mirëfillta fetare, në zgjidhjen e çështjes së pronave të tyre, në çështje të arsimimit fetar, në promovimin e vlerave kulturore fetare në vend e në diasporë, duke ruajtur laicitetin dhe asnjëanësinë e shtetit në raport me bashkësitë dhe shoqatat fetare, si dhe barazinë e tyre para ligjit.

Për këtë qëllim, garantimi i një mjedisi ku çdo bashkësi fetare të shprehë dhe praktikojë lirisht besimin e vet si dhe trajtimi dhe kthimi i aseteve të mundshme bashkësive fetare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, është një prioritet i Komitetit Shtetëror për Kultet. Njëkohësisht, duke konsideruar BF dhe shoqatat fetare si pjesë aktive e shoqërisë dhe partnere të shtetit në zgjidhjen e plagëve të ndryshme sociale, gjatë vitit 2010, duhet intensifikuar ndjeshëm ndikimi i KSHK – së në forcimin e marrëdhënieve bashkëpunuese mes tyre dhe pushtetit qendror e vendor

3) DREJTIMET KRYESORE DHE MËNYRAT E REALIZIMIT

Si për çdo institucion të administratës shtetërore, funksionimi i Komitetit Shtetëror për Kultet bëhet në bazë të direktivave dhe strategjive qeveritare. Duke patur parasysh natyrën e veçantë të punës që lidhet me anën shpirtërore të besimtarëve dhe sfidat me të cilat përballet shoqëria e sotme shqiptare dhe jo vetëm, paraqiten mëposhtë kanalet ku duhet të fokusohet vëmendja e institucionit.

• MBI DISA NDRYSHIME DHE PËRMIRËSIME LIGJORE

❖ Garantimi i zbatimit ligjor të Marrëveshjeve të nënshkruara mes Këshillit të Ministrave dhe Bashkësive Fetare, shoqëruar me amendimet e mundshme ligjore.

Viti 2021 duhet të shënojë një vit të rëndësishëm në zbatimin rigoroz të Marrëveshjeve të sipërpërmendura, të pasqyruara në Ligjin Nr. 8902, datë 23.05.2002, Ligjin Nr. 10056, Nr. 10057, Nr. 10058, datë 22.01.2009 dhe Ligjin nr. 10394, datë 10.03.2011. Shteti shqiptar është garantues i së drejtës së lirisë së besimit fetar dhe për këtë qëllim krijon kushtet për përmbushjen e kësaj të drejte. Zbatimi i ligjit nr. 10140, datë 15.05.2009, “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, nëpërmjet përgatitjes së aktit nëligjor për këtë qëllim. Në vijim të procesit të rishikimit të këtyre marrëveshjeve, brenda vitit 2021 duhet të jenë përpiluar draft – propozimet ligjore.

❖ Gjatë këtij viti duhet shtuar angazhimi për vendosjen e kritereve të grupimeve fetare që mund të nënshkruajnë marrëveshje me Këshillin e Ministrave, para në kuadrin e një legjislacioni për fenë, i cili ende sot mungon në Shqipëri. Me rëndësi gjithashtu, duhet të konsiderohet rishikimi i kritereve të regjistrimit dhe ndjekshmërisë së aktivitetit të shoqatave/organizatave/fondacioneve OJF fetare, në bashkëpunim me institucione të tjera shtetërore. Ndjeshmëria dhe përgjegjshmëria për trajtimin e këtij aspekti, duhet të jenë prioritare.

❖ Viti 2021 duhet të shënojë vitin e vijimit të iniciativave të KSHK për t’i ardhur në ndihmë zgjidhjes së procesit të ndërlikuar të kthimit të pronave bashkësive fetare, nëpërmjet propozimeve ligjore. Sigurisht, kjo do të bëhet në bashkëpunim të plotë me insitucionet përkatëse.

**• FORCIMI I MARRËDHËNIEVE ME BASHKËSITË FETARE
DHE
ZGJIDHJA E PROBLEMATIKAVE TË TYRE**

❖ Ky objektivi që përbën një nga shtyllat për përmbushjen e rolit institucional, duhet të realizohet nëpërmjet kontaktit të vazhdueshëm me BF, intensifikimit të përpjekjeve për njohjen nga afër të problematikave të tyre, shtimit të iniciativës në zgjidhje e shpejtë të sa më sipër. Për këtë qëllim do të parashikohen të paktën dy takime mujore për secilën bashkësi fetare. Mbështetja e KSHK për nismat që promovojnë dialogun dhe bashkëjetesën ndërfaqetare do të jetë e gjithanshme. Nuk do të lihen mënjanë aktivitetet e organizuara nga bashkësitë, ku do të sigurohet pjesëmarrja dhe ndihma e përfaqësuesve të KSHK. Sigurisht, planet e punës mujore, të hartuara e miratuara paraprakisht, do të jenë udhëzues veprimi.

❖ Gjatë vitit 2021, në varësi të situatës pandemike, duhet fokusuar në dhënien jetë të projekteve të përbashkëta për trajtimin e çështjeve me rëndësi për shoqërinë shqiptare, ku mund të përmendim:

- Projekte për nxitjen e bashkëpunimit mes shtetit dhe bashkësive /shoqatave në nivel qendror/vendor, për përmirësimin e realiteteve lokale dhe jetës komunitare.

- Projekte me karakter promovues të shembullit tradicional të bashkëjetesës fetare në Shqipëri dhe jashtë saj.

- Projekte me karakter nxitjen dhe forcimin e dialogut mes shtetit dhe feve, drejtuar jo vetëm bashkësive fetare, por edhe shoqatave të ndryshme me karakter humanitaro – fetar që operojnë në vend, në nivel qendror dhe lokal.

**• THELLIMI I BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONET SHTETËRORE
QË LIDHEN ME ÇËSHTJET FETARE**

❖ Gjatë vitit 2021 pozicioni i KSHK –së, në raport me institucionet shtetërore që trajtojnë çështje të lidhura me bashkësitë apo shoqatat fetare, duhet ngritur në një nivel akoma më cilësor dhe të rëndësishëm. Për këtë qëllim duhen intensifikuar takimet, informacionet e dhëna e të marra, propozimet për projekte të përbashkëta, të forcohet vijueshmëria dhe mbikqyrja e zgjidhjes së problematikave shqetësuese etj.

Raportet me ASHK, QKEDH, MASR, MPEJ dhe me Pushtetin Vendor etj. duhen thelluar më tej, në shërbim dhe funksion të rolit ligjor institucional dhe duhet instistuar në zgjidhjen përfundimtare të çështjeve. Indiferentizmi apo mefshtësia e disa institucioneve nuk duhet të bëhen shkas për moszgjidhjen apo zvarritjen e shqetësimeve.

- **NGRITJA dhe PROMOVIMI I POZICIONIT TË KSHK NË SHKALLË RAJONALE DHE BOTËRORE**

Viti 2021, parë nën këndvështrimin e pandemisë dhe kufizimeve që e shoqërojnë, do të përcillet domosdorisht nga një reduktim i udhëtimeve jashtë vendit. Megjithatë, kjo nuk duhet të pengojë KSHK të zbatojë detyrën ligjore të tij. Për këtë qëllim ky objektivi do të arrihet nëpërmjet:

- ❖ Promovimit institucional të KSHK –së, në takimet e shpeshta që duhet të zhvillohen me përfaqësuesit diplomatikë të vendeve të huaja në Republikën e Shqipërisë.
- ❖ Pjesëmarrjes aktive në workshope, konferenca, simpoziume etj, në shkallë rajonale dhe ndërkombëtare, ku të paraqiten saktë dhe qartë roli, puna dhe arritjet e institucionit.
- ❖ Përgatitjes së raportimeve ndërkombëtare lidhur me çështjen e lirisë së besimit dhe fesë në Shqipëri.
- ❖ Shkëmbimeve të vazhdueshme me diasporën shqiptare nëpër botë, jo vetëm në formë korrespondence, por edhe nëpërmjet takimeve direkte.
- ❖ Fuqizimit të shkëmbimeve të eksperiencës me homologët e KSHK në botë, sidomos në vende me ngjashmëri të kuadrit të larmishëm fetar dhe mepërvojë të konsoliduar në çështjet e fesë.

4) PROJEKTET E KSHK – së

Duke patur parasysh panoramën fetare në vend dhe duke i konsideruar BF dhe Shoqatat me karakter fetar si partnerë në zgjidhjen e plagëve sociale, KSHK –ja për vitin 2021 parashikon:

- ❖ Vazhdimin e studimit trevjeçar mbi nivelin e marrëdhënieve mes pushtetit vendor dhe komuniteteve lokale fetare, për t'i dhënë një shtytje bashkëpunimit mes tyre për të mirën e përbashkët. Gjatë vitit 202 do të mbulohen bashkitë dhe njësitë administrative të Shqipërisë së Mesme.
- ❖ Krijimin e networkut rajonal të bashkëpunimit mes homologëve, për shkëmbim eksperiencash, promovim vlerash të bashkëjetesës fetare, rritje të sigurisë rajonale.
- ❖ Lançimin e një projekti afatgjatë disavjeçar, në bashkëpunim me MEPJ dhe bashkësitë fetare, për promovimin e shembullit unik të bashkëjetesës fetare shqiptare, në trevat shqipfolëse të rajonit, i cili, gjatë vitit të kaluar, u pezullua për shkak të pandemisë.

5) PARASHIKIMI BUXHETOR ME ZËRAT PËRKATËS

Bazuar në ligjin nr. 137 datë 16.11.2020 “Per buxhetin e vitit 2021” dhe në mbështetje të objektivave të parashtruara, të rezultateve të arritura dhe realizimeve buxhetore gjatë vitit 2020, shuma që i është akorduar KSHK-së është 134.500.000 lekë, e ndarë në zërat specifike ekonomike¹. Për përdorimin me efikasitet e përgjegjshmëri të këtij fondi, do të vazhdojë të veprojë Grupi i Menaxhimit Strategjik që do të monitorojë shpenzimet me realizimin e objektivave dhe do të ndërhyjë në zgjidhjen e mangësive që mund të evidencohen. Nëpunësja zbatuese duhet të ndjekë hap pas hapi realizimin e tyre dhe t’i reflektojë ato në pasqyrat periodike të parashikuara me ligj, duke respektuar afatet kohore dhe titullari, në rolin e nëpunësit autorizues duhet të ushtrojë kompetencat e tij, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nevojat institucionale shtrojnë nevojën e prokurimeve me blerje të vogël² dhe komisioni i ngritur për këtë qëllim, të zbatojë rigorozisht të gjitha procedurat ligjore për të siguruar transparencën maksimale. Njëkohësisht, promovimi i bashkëjetesës fetare në nivel ndërkombëtar dhe krijimi i një rrjeti bashkëpunues mes homologësh, si pjesë të detyrave ligjore, të shprehura në VKM nr. 459, datë 23.09.1999, “Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet, pika 2, pragrafi 8, parashtrojnë nevojën e parashikimit të udhëtimeve jashtë vendit³.

TABELA NR. 1 E SHPENZIMEVE TË MIRATUARA PËR VITIN 2021,

SIPAS LIGJIT nr. 137 , datë 16.11.2020

EMËRTIMI I PROGRAMIT	TOTALI I SHPENZIMEVE KORRENTE (MIJË LEKË)		TOTALI I SHPENZIMEVE KAPITALE (MIJË LEKË)	TOTALI I SHPENZIMEVE BUXHETORE (MIJË LEKË)
	PERSONELI	TË TJERA		
	12,255	121,245		
MBËSHTETJE PËR KULTET FETARE	133,500		1,000	134,500

¹ Referohu Tabelës nr. 2

² Referohu Tabelës nr. 3

³ Referohu Tabelës nr. 4

**TABELA NR. 2 E PARASHIKIMIT BUXHETOR SIPAS ZËRAVE EKONOMIKË
PËR VITIN 2021**

<i>KAPITULL</i>	<i>ARTIKULL</i>	<i>EMËRTIMI</i>	<i>PLANI VJETOR</i>
01	6009999	SHPENZIME PERSONELI	12,255,000
01	6029999	SHPENZIME TË TJERA	121,245,000
01	2310000	SHPENZIME KAPITALE	
		TOTALI	133,500,000
<i>KAPITULL</i>	<i>ARTIKULL</i>	<i>EMËRTIMI</i>	<i>PLANI VJETOR</i>
01	600	PAGA TOTALI	<u>10,512,000</u>
	6001001	PAGAT BAZË	1,512,000
	6001002	RAPORTE MJEKSORE	
	6001003	SHTESË VJETËRSIE	702,000
	6001004	SHTESË VJETËRSIE	
	6001005	SHTESË FUNKSIONI	8,298,000
	6001008	SHTESE PAGE PER KULIFIKIM	
	6001013	SHTESE PAGE PER PUNE JASH ORARI	
	6001099	SHTESE PAGE TE TJERA	
	600902	PAGE ME KONTRATE	
	600903	FONDI VEÇANTË	
01	601	KONTRIB.SIG.SHOQ.SHEND. TOTALI	<u>1,743,000</u>
	60101	SIGURIME SHOQËRORE	1,743,000
	60111	SIGURIME SHENDETESORE	

01	602	MALLRA E SHËRB. TJERA. TOTALI	<u>8,245,000</u>
01	<u>6020</u>	<u>MAT.DHE SHËRBIME</u>	<u>510,000</u>
	60201	KANCELARI	120,000
	60202	MAT.PËR PASTRIM DHE SHËRB.	250,000
	60203	MAT.PËR FUNK E PAJS TE ZYRES	120,000
	60209	MAT.SHERB.TE TJERA	20,000
01	<u>6021</u>	<u>MATERIELE DHE SHËRB.SPECIALE</u>	<u>240,000</u>
	602107	LIBRA DHE PUBLIKIME	120,000
	602199	TË TJERA MAT.DHE SHËRB.SPECI	120,000
01	<u>6022</u>	<u>SHËRBIME</u>	<u>1,600,000</u>
	6022001	ENERGJI	210,000
	6022002	UJE	100,000
	6022003	TELEFON	210,000
	6022004	POSTA	50,000
	6022007	SHËRBIME BANKARE	10,000
	6022010	SHERBIME PRINT PUBLIKIM	120,000
	6022099	SHERBIME TE TJERA,INTERNET	900,000
01	<u>6023</u>	<u>SHPENZIME TRANSPORTI</u>	<u>1,390,000</u>
	60231	KARBURANT DHE VAJ	700,000
	60232	MIRËMB.E MJETEVE TRANSP.	450,000
	60233	KOSTO E SIGUR.MJETEVE TRANSP.	120,000
	60239	SHPENZ.TË TJERA TRANSP.	120,000
01	<u>6024</u>	<u>SHPENZIME UDHËTIMI</u>	<u>2,965,000</u>

	60240	UDHËTIM BREND/JASHT.	2,965,000
01	<u>6025</u>	<u>MIRËMBAJTJE TË ZAKONSHME</u>	<u>1,280,000</u>
	60253	SHPEN.MIRËMB.OBJEK.NDËRTIM	800,000
	60254	SHPEN.MIRËMB.HIDRULI.ELEKTRIK	120,000
	60255	MIREM. KONDICIONER ETJ	120,000
	60256	SHPENZIME PËR MIRËMBAJTJE MJETE TRANSPORTI	120,000
	60258	MIRËM.PAJISJE ZYRE (FAX, ETJ)	120,000
1	602.6	SHPENZIME PËR QERAMARRJE	<u>50,000</u>
	602.61	SHPENZIME PER QERAMARRJE AMBJENTESH	50,000
01	<u>6029</u>	<u>SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE</u>	<u>210,000</u>
	6029001	SHPENZ.PRITJE/PËRCJELLJE	120,000
	6029003	SHPENZ GJYQËSORE	20,000
	6029004	SHPENZ PËR SIGURIMIN E NDERTESAVE	40,000
	6029008	SHPENZ.PËR TATIME DHE TAX TE PAG NGA INSTITUCIONI	30,000
01	604	TRANSFERTA BASHKËSIVE FETARE	<u>113,000,000</u>
	6044099	TË TJERA TRANSFERTA PËR INSTITUCIONET JO-FITIM PRURËSE (BASHKËSIVE FETARE)	113,000,000
	TOTALI SHPENZIMEVE		121,245,000
	<u>PARASHIKIMI I INVESTIMEVE PËR VITIN 2021</u>		
<i>KAPITULL</i>	<i>ARTIKULL</i>	<i>EMËRTIMI</i>	<i>PLANI VJETOR</i>
01	2310000	BLERJE PAJISJE ZYRE	<u>200,000</u>
01	2310000	BLERJE PAJISJE KOMPJUTERIKE	<u>800,000</u>
TOTALI			1,000,000

TABELA NR. 3 E REGJISTRIT TË PROKURIMEVE ME BLERJE TË VOGËL

TË PARASHIKUARA PËR VITIN 2021

<i>Nr.</i>	<i>Objekti i Prokurimit</i>	<i>Lloji i regjistrit të prokurimit</i>	<i>Fondi i përlogaritur</i>	<i>Burimi i Financimit</i>	<i>Vlera</i>	<i>Lloji i procedurës së prokurimit</i>
1	Furnizime dhe materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme	Blerje nën vlerën 100 000 Lekë	16666.00	Buxheti i shtetit	16666.00	
2	Shërbime Mirëmbajtje pajisje zyre	Blerje nën vlerën 100 000 Lekë	100000.00	Buxheti i shtetit	100000.00	
3	Blerje pajisje kompjuterike	Procedurë Prokurimi	166666.00	Buxheti i shtetit	166666.00	Small Value
4	Mirëmbajtje të kondicionerëve etj.	Blerje nën vlerën 100 000 Lekë	100000.00	Buxheti i shtetit	100000.00	
5	Mirëmbajtje/ riparime të automjetit të institucionit.	Procedurë Prokurimi	375000.00	Buxheti i shtetit	375000.00	Small Value
6	Dizinfektim i ambienteve të brendshme të zyrave të KSHK	Procedurë Prokurimi	166666.00	Buxheti i shtetit	166666.00	Small Value
7	Meremetime dhe lyerje e brendshme e zyrave	Procedurë Prokurimi	666666.00	Buxheti i shtetit	666666.00	Small Value
8	Bileta transporti ajror ndërkombëtar	Procedurë Prokurimi	450000.00	Buxheti i shtetit	450000.00	Purchase Tickets

9	Abonime vjetore në shtypin vendas	Blerje nën vlerën 100 000 Lekë	100000.00	Buxheti i shtetit	100000.00	
10	Shërbime pastrimi zyrat e KSHK	Procedurë Prokurimi	250000.00	Buxheti i shtetit	250000.00	Small Value
11	Shërbime Mirëmbajtje hidraulike, elektrike etj	Blerje nën vlerën 100 000 Lekë	100000.00	Buxheti i shtetit	100000.00	
12	Pritje/ përcjellje	Blerje nën vlerën 100 000 Lekë	100000.00	Buxheti i shtetit	100000.00	
13	Sigurimi i mjetit të transportit	Blerje nën vlerën 100 000 Lekë	100000.00	Buxheti i shtetit	100000.00	
14	Shërbime mirëmbajtjeje (periodike) të automjetit	Blerje nën vlerën 100 000 Lekë	100000.00	Buxheti i shtetit	100000.00	
15	Blerje kancelarie	Blerje nën vlerën 100 000 Lekë	100000.00	Buxheti i shtetit	100000.00	
16	Blerje toner për printer dhe fotokopje	Blerje nën vlerën 100 000 Lekë	100000.00	Buxheti i shtetit	100000.00	
17	Shpenzime të tjera transporti	Blerje nën vlerën 100 000 Lekë	100000.00	Buxheti i shtetit	100000.00	
18	Blerje pajisje zyre	Procedurë Prokurimi	666666.00	Buxheti i shtetit	666666.00	Small Value
19	Shërbime printimi	Blerje nën vlerën 100 000	100000.00	Buxheti i shtetit	100000.00	

		Lekë				
20	Sigurim i zyrave të KSHK-së	Blerje nën vlerën 100 000 Lekë	33333.00	Buxheti i shtetit	33333.00	
21	Blerje karburanti	Procedurë Prokurimi	583333.00	Buxheti i shtetit	583333.00	Small Value
22	Materiale pastrimi, dizinfektimi dhe mjete mbrojtëse nga Covid	Procedurë Prokurimi	208333.00	Buxheti i shtetit	208333.00	Small Value

TABELA NR. 4 E PLANIFIKIMIT TË UDHËTIMEVE JASHTË VENDIT

PËR VITIN 2021

NR	VENDI PËR KU UDHËTOHET	QËLLIMI	PERIUDHA	NR I PUNONJËSVE	NR I DITËVE	BUXHETI I PARASHIKU AR
1	Austri	Pjesëmarrje në takimet e përvitshme të ODHIR, HDIM (min 2 aktivitete)	Në pritje të kalendarit të ODHIR	1 * 2 aktiv.	3 * 2 aktiv.	2000 €
2	Francë	Pjesëmarrje në aktivitete me BF dhe takim me klerin e diasporës	Maj – Qershor	2	3	2220 €
3	USA	Pjesëmarrje në ministerialin e DASH për fenë	Korrik	1	5	3600 USD
4	Bosnjë Hercegovinë / Bullgari	Njohje dhe shkëmbim eksperience për krijimin e bazave të një networku mes homologësh	Shtator	3 + 1	5	3000 €
5	Poloni	Pjesëmarrje në takimin e përvitshëm të HDIM	Në pritje të kalendarit HDIM	1	3	2000 €